



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

RREGULLORE

**PËR APLIKIMIN DHE PËRZGJEDHJEN E PERSONELIT TË FARSH PËR ARSIMIM
DHE TRAJNIM BRENDË DHE JASHTË VENDIT**

Miratuar me Urdhër të Ministrit të Mbrojtjes
Nr. 2175, datë 23.11.2017

Tiranë, 2017

I. Të përgjithshme

1. Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave transparente të punës që do të ndiqen dhe do të zbatohen nga strukturat e përmendura në këtë rregullore për të vlerësuar personelin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH) për kualifikim brenda dhe jashtë vendit.

2. Qëllimi

Qëllimi rregullores është të sigurojë që vlerësimi dhe rekomandimi për kualifikimin e personelit të FARSH të jetë i drejtë, i paanshëm, objektiv, i barabartë dhe transparent.

3. Përkufizime

Në kuptimin e kësaj rregulloreje termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) *“Kurset Institucionalë”* janë pjesë përbërëse e sistemit të arsimit dhe kualifikimit të personelit ushtarak, me qëllim aftësimin e personelit oficer, nënoficer dhe ushtar, si dhe një nga kriteret ligjore kryesore për përparimin në gradë.
- b) *“Kurset funksionale”* janë pjesë përbërëse e sistemit të arsimit dhe kualifikimit të personelit ushtarak, me qëllim aftësimin e personelit oficer, nënoficer në kryerjen e detyrës funksionale.
- c) *“Lista e meritës”* është lista e vlerësimit të personelit ushtarak dhe civil (për kurse që janë objekt e kësaj rregulloreje) sipas meritës, me pikë ose me notë, në rendin zbritës, në përfundim të procesit të vlerësimit nga strukturat që menaxhojnë procesin.
- d) *“Drejtoria përgjegjëse”* në Ministrinë e Mbrojtjes është drejtoria e cila me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes menaxhon procesin e arsimit të personelit në Forcat e Armatosura.

II. Procedurat për planifikim për trajnimin dhe arsimimin e personelit të Forcave të Armatosura në kurse institucionale jashtë vendit dhe kurse funksionale brenda dhe jashtë vendit.

1. Gjatë vitit kalendarik, Shtabi i Përgjithshëm, në bashkëpunim me degët e personelit në Forca, komandat kryesore, njësitë, repartet dhe Drejtorinë përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes (MM), nëpërmjet programeve të ofruara ndër vite nga Zyra Amerikane për Bashkëpunimin Ushtarak (ODC) dhe historikut të kurseve të ofruara nga vendet partnere dhe aleate, të identifikojë nevojat për trajnim dhe arsimim në kurse institucionale dhe funksionale brenda dhe jashtë vendit, për dy vitet pasardhës.
2. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, brenda muajit nëntor të çdo viti kalendarik, bazuar në nevojat e Forcave të Armatosura, për trajnim dhe arsimim në institucionet arsimore ushtarake brenda dhe jashtë vendit, vlerëson dhe miraton nevojat e identifikuar për trajnim dhe arsimim në kurse institucionale dhe funksionale brenda dhe jashtë vendit, për dy vitet pasardhës nga viti aktual kalendarik.
3. Drejtoria e Personelit (J-1), pas miratimit nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, brenda muajit nëntor, i përcjell drejtorisë përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes listën e nevojave të

identifikuara për trajnim dhe arsimim në kurse institucionale dhe funksionale brenda dhe jashtë vendit, për dy vitet pasardhëse.

4. Drejtoria përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes, pas miratimit nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, i paraqet vendeve partnere dhe aleate listën e nevojave për trajnim dhe arsimim në institucionet arsimore ushtarake, deri në dy vitet pasardhëse.
5. Drejtoria përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes, bazuar në listën e nevojave për trajnim dhe arsimim, të paraqitur vendeve partnere dhe aleate, jo më vonë se data 1 qershor e çdo viti pret listën paraprake të kurseve/trajnime të ofruara për vitin e ardhshëm.
6. Në rastet kur kjo listë, për arsye objektive, nuk është shpallur akoma nga vendet partnere dhe aleate, çdo ftesë e ardhur të trajtohet rast pas rasti sipas procedurave të përcaktuara në kreun III.
7. Drejtoria përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes, bazuar në listën e kurseve/trajnimeve të ofruara nga vendet partnere dhe aleate/ose ftesat rast pas rasti, jo më vonë se pesë ditë pune, i përcjell drejtorive në Ministrinë e Mbrojtjes, Drejtorisë së Personelit/J-1 në Shtabin e Përgjithshëm dhe Qendrës së Personel Rekrutimit, planin e kurseve të ardhur nga vendet partnere dhe aleate. Ky plan të përmbajë:
 - Titullin e kursit dhe koston
 - Përshkrimin e shkurtër të kursit dhe vendi ku zhvillohet
 - Periudhën e zhvillimit të kursit, kur është e përcaktuar
 - Afati i aplikimit (aplikimi sipas skemës)
 - Kriteret për ndjekjen e kursit

III. Procedurat për njoftimin, aplikimin dhe identifikimin e kandidaturave për arsimimin e personelit të Forcave të Armatosura brenda dhe jashtë vendit

1. Drejtoria përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes nëpërmjet QKMBM-s bën publikimin e njoftimit për kurset përkatëse në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm. Njoftimi duhet të jetë lehtësisht i dukshëm dhe të përmbajë tabelën e kurseve (në formatin “pdf”), shembuj të dokumentacionit që duhet të plotësohet për aplikim (në formatin “word/exel”) dhe mënyrën e aplikimit.
2. Drejtoria përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes i përcjell Drejtorisë së Personelit (J-1) në Shtabin e Përgjithshëm dhe Qendrës së Personel Rekrutimit, në mënyrë elektronike, planin e kurseve të ofruara nga Zyra Amerikane e Bashkëpunimit Ushtarak, sipas “Listës së Integruar dhe të Standardizuar të Trajnimeve (STL)”, “Planin e arsimimit dhe kualifikimit brenda vendit”, planin e kurseve të ofruara nga vendet partnere dhe aleate, në rastet kur ky plan është i njohur, si dhe kurse/trajnime të paplanifikuara të ofruara rast pas rasti. Në rast të problemeve teknike, të cilat shkaktojnë pamundësi të komunikimit elektronik, ky komunikim bëhet në mënyrë shkresore.
3. Drejtoria përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes i përcjell personelit të strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes, në mënyrë elektronike (e-mail), kursin/kurset e ofruara, për të cilat

kërkohen kandidatura. Njoftimi i dërgohet direkt të gjithë personelit ushtarak e civil sipas gradës që përcaktohet në kriteret e kursit/trajnimin sipas lidhjes 3, si dhe për dijeni drejtorëve të drejtorive në MM, degëve/sectorëve të personelit (S-1) dhe Qendrës së Personel Rekrutimit.

4. Drejtorja e Personelit (J-1) në SHP i përcjell personelit të forcave dhe komandave, si dhe të strukturave në varësi të Shtabit të Përgjithshëm, në mënyrë elektronike (e-mail), kursin/kurset e ofruara, për të cilat kërkohen kandidatura. Njoftimi i dërgohet direkt sipas lidhjes 3 të gjithë personelit ushtarak e civil sipas gradës që përcaktohet në kriteret e kursit/trajnimin, degëve/sectorëve të personelit (S-1/G-1), si dhe për dijeni Qendrës së Personel Rekrutimit.
5. Të gjitha strukturat e FARSH bëjnë publikimin e njoftimeve për kurset përkatëse në këndet e njoftimeve pranë çdo strukture si dhe ambiente të tjera ku mund të sigurohet informim masiv i personelit. Njoftimet duhet të jenë lehtësisht të dukshme dhe të përmbajnë tabelën e kurseve, shembuj të dokumentacionit që duhet të plotësohet për aplikim dhe mënyrën e aplikimit.
6. Personeli i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë aplikon në mënyrë individuale në rrugë elektronike duke ju drejtuar Qendrës së Personel Rekrutimit sipas lidhjes 4, si dhe për dijeni pikës së kontaktit në drejtorinë përgjegjëse në MM. Për çdo aplikim individual duhet të vihet për dijeni struktura eprore e drejtpërdrejtë (degët dhe seksionet e personelit G-1/A-1/N-1/S-1 dhe drejtorët e drejtorive sipas vartësisë).
7. Degët dhe seksionet e personelit G-1/A-1/N-1/S-1, në rastet kur personeli i strukturave të tyre të vartësisë e ka të pamundur qasjen dhe aplikimin në rrugë elektronike t'u mundësojnë aplikimin personelit të tyre të vartësisë, nëpërmjet kapaciteteve zyrtare që disponojnë.
8. Strukturat eprore të aplikantëve, në rast se konstatojnë aplikime të personelit të vartësisë për kurset e shpallura dhe njëkohësisht personeli i tyre është planifikuar për misione, stërvitje ose aktivitete të tjera dhe shpëputja e tyre nga detyra për ndjekjen e kursit përkatës cënon realizimin me sukses të detyrave/misionit, si dhe në rastet kur aplikanti ka probleme integriteti, kjo strukturë brenda përfundimit të afatit të aplikimeve duhet të drejtohen zyrtarisht drejtorisë përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes për pushimin e vijimit të procedurave të mëtejshme të personelit të tyre të vartësisë. Në çdo rast kërkesa e tyre duhet të jetë e motivuar.
9. Qendra e Personel Rekrutimit pasi përpunon të gjitha aplikimet elektronike individuale bën listë meritën paraprake të kandidatëve, bazuar në kriteret e kurseve të përcaktuara në lidhjet 1 dhe 2 dhe ia përcjell ato në rrugë elektronike drejtorisë përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes, sipas lidhjes 5. Në mungesë të aplikimeve nga personeli i Forcave të Armatosura, bën konfirmimin në Drejtorinë e Personelit në Shtabin e Përgjithshëm të FA-s.
10. Në rastet e mungesës së aplikimeve, Drejtorja e Personelit (J-1) në bashkëpunim me Qendrën e Personel Rekrutimit identifikon nga sistemi i automatizuar (data-base) kandidatura të mundshme, në përputhje me kriteret e përcaktuara. Për kandidaturat e identifikuara nga sistemi i automatizuar, merret miratimi i strukturave eprore në të cilat këto kandidatura shërbejnë, para fillimit të procesit të përzgjedhje dhe miratimit.

11. Për kurse/trajtime të paplanifikuara të ofruara rast pas rasti, të cilat kanë një afat më të ngushtë se 150 ditë nga data e fillimit të kursit, procedurat për identifikimin dhe aplikimin e kandidatëve për arsimimin e personelit të Forcave të Armatosura jashtë vendit të zhvillohen sipas përcaktimeve në paragrafët 1-10 të këtij kapitulli, në bazë të afateve kohore që përcaktohen sipas rastit:

11.1. Aplikimi individual të bëhet brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftimin elektronik.

11.2. Qendra e Personel Rekrutimit të përcjell të gjitha propozimet brenda afatit kohor të përcaktuar nga komunikimi i përbashkët me Drejtorinë e Personelit (J-1) dhe drejtorinë përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes.

IV. Procedurat për testimin, përzgjedhjen dhe miratimin e kandidatëve për arsimimin e personelit të Forcave të Armatosura brenda dhe jashtë vendit

1. Drejtoria përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes, bazuar në planin e kurseve të ofruara nga Zyra Amerikane e Bashkëpunimit Ushtarak, sipas “Listës së Integruar dhe të Standardizuar të Trajnimeve (STL)”, “Planin e arsimimit dhe kualifikimit brenda vendit”, planin e kurseve të ofruara nga vendet partnere dhe aleate, në rastet kur ky plan është i njohur, dhe propozimet e bëra, sipas procedurave të përcaktuara në kapitullin “III”, në harkun kohor 140-130 ditë, nga data e fillimit të kursit, organizon dhe zhvillon testimin ALCPT për gjuhën e huaj, në Qendrën e Gjuhëve të Huaja në KDS, për evidentimin e kandidatëve që arrijnë nivelin gjuhësor të kërkuar.

2. Për kurset institucionale dhe funksionale që zhvillohen në kuadër të Programit të kombinuar për menaxhimin e arsimimit dhe kualifikimit (Combined Education Training Program Management), kandidatët të cilët nuk kualifikohen në testimin ALCPT dhe/ose arrijnë një rezultat më të ulët se 9 (nëntë) pikë nga niveli i kërkuar, nuk mund t'i nënshtrohen testimit ECL dhe nuk vijnë në procesin e mëtejshëm.

3. Për kurset institucionale dhe funksionale që zhvillohen në kuadër të Programit të kombinuar për menaxhimin e arsimimit dhe kualifikimit (Combined Education Training Program Management/CETPM) drejtoria përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes, 120 ditë nga data e fillimit të kursit, i përcjell Zyrës Amerikane të Bashkëpunimit Ushtarak, për vlerësim dhe rekomandim paraprak, praktikën përkatëse. Kjo praktikë të përmbajë:

– Shkresë, drejtuar Zyrës Amerikane të Bashkëpunimit Ushtarak, për vlerësim dhe miratim të kandidatëve të propozuar.

– Listë meritën e kandidatëve të propozuar për ndjekjen e kursit përkatës.

– CV-të, në gjuhën angleze, të kandidatëve të propozuar për ndjekjen e kursit përkatës.

– Përshkrim pune, në gjuhën angleze, të kandidatëve të propozuar për ndjekjen e kursit përkatës, për pozicionin e punës që kandidati mban.

– Përshkrimi i kursit, në gjuhën angleze.

4. Për kurset institucionale dhe funksionale që zhvillohen në kuadër të Programit të kombinuar për menaxhimin e arsimimit dhe kualifikimit (CETPM) Zyra Amerikane e Bashkëpunimit

Ushtarak (ODC), jo më vonë se 115 ditë nga data e fillimit të kursit vlerëson, miraton ose refuzon kandidatët e miratuar duke dhënë argumentimet përkatëse, kur është e nevojshme. Në vlerësimin e kandidaturave të propozuara do të merret në konsideratë fakti nëse kandidatët e miratuar kanë ndjekur më parë kualifikime nëpërmjet programeve amerikane të trajnimit. Ky nuk do të jetë faktor përcaktues por prioritet do të kenë kandidatët të cilët nuk kanë ndjekur më parë kualifikime nëpërmjet këtyre programeve.

5. Për kurset institucionale dhe funksionale që zhvillohen në kuadër të Programit të kombinuar për menaxhimin e arsimimit dhe kualifikimit (CETPM) drejtoria përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes, bazuar në vlerësimin dhe rekomandimin e Zyrës Amerikane të Bashkëpunimit Ushtarak (ODC), koordinon dhe organizon zhvillimin e testimit ECL. Testimi ECL të zhvillohet jo më herët se 105 ditë dhe jo më vonë se 95 ditë nga data e fillimit të kursit. Në të njëjtin hark kohor, drejtoria përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes, në bashkëpunim me Qendrën e Personel Rekrutimit dhe ODC, organizon dhe zhvillon testimin fizik (Army Physical Fitness Test “APFT”) me kandidatët të cilët duhet t’i nënshtrohen testimit fizik. Vlerësimi i kandidatëve në këto teste është kompetencë e Zyrës Amerikane për Bashkëpunim.
6. Zyra Amerikane e Bashkëpunimit Ushtarak zhvillon testimin gjuhësor (ECL) vetëm për tre kandidatë për një kuotë të çdo kursi. Në testimin ECL marrin pjesë kandidatët të cilët janë kualifikuar në testimin ALCPT dhe/ose kanë arritur një rezultat jo më të ulët se 9 (nëntë) pikë nga niveli i kërkuar. Në testimin fizik marrin pjesë kandidatët të cilët janë kualifikuar në testimin ECL.
7. Për kurset institucionale dhe funksionale që zhvillohen në kuadër të Programit të kombinuar për menaxhimin e arsimimit dhe kualifikimit (CETPM) drejtoria përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes, bazuar në vlerësimin dhe rekomandimin e Zyrës Amerikane të Bashkëpunimit Ushtarak (ODC), rezultatet e testimit gjuhësor ECL dhe në kriteret e përcaktuara sipas lidhjes 1 dhe 2, jo më vonë se 90 ditë nga data e fillimit të kursit bën listë meritën përfundimtare të kandidatëve dhe nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm dhe Shefit të Shtabit të Përgjithshëm ia përcjell ato Ministrit të Mbrojtjes për vlerësim dhe miratim.
8. Për kurset e tjera institucionale jashtë vendit dhe kurset funksionale brenda dhe jashtë vendit, drejtoria përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes, pasi përpunon të gjitha aplikimet, bazuar në listë meritën paraprake hartuar nga Qendra e Personel Rekrutimit, rezultatet e testimit gjuhësor ALCPT dhe në kriteret e përcaktuara sipas lidhjes 1 dhe 2, jo më vonë se 90 ditë nga data e fillimit të kursit bën listë meritën përfundimtare të kandidatëve dhe nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm dhe Shefit të Shtabit të Përgjithshëm ia përcjell ato Ministrit të Mbrojtjes për vlerësim dhe miratim.
9. Drejtoria përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes, 90 - 70 ditë nga data e fillimit të kursit, në bazë të miratimit nga autoritetet kompetente në Ministrinë e Mbrojtjes, të një kandidati parësor dhe një kandidati rezervë, harton projekt-urdhrin “Për dërgim jashtë shtetit për kualifikim”, për ndjekjen e kurseve përkatëse.
10. Për kurset që zhvillohen në kuadër të Programit të kombinuar për menaxhimin e arsimimit dhe kualifikimit (Combined Education Training Program Management), drejtoria përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes, në harkun kohor 65 ditë nga data e fillimit të kursit, i konfirmon

Zyrës Amerikane të Bashkëpunimit të dhënat e kandidatit/kandidatëve parësorë dhe rezervë, të miratuar për ndjekjen e programeve amerikane të trajnimit dhe arsimimit.

11. Në raste të veçanta, kur për nevoja operacionale kërkohet që kandidati i miratuar të angazhohet në detyrë tjetër, zhvillohen procedurat përkatëse për sigurimin e pjesëmarrjes në kurs nga kandidati rezervë.
12. Për kurse/trajnime të paplanifikuara të ofruara rast pas rasti, të cilat kanë një afat më të ngushtë se 150 ditë nga data e fillimit të kursit, drejtoria përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes përcakton afatet kohore për procedurat e testimit dhe përzgjedhjes së kandidaturave për arsimimin brenda dhe jashtë vendit sipas vlerësimit të saj.
13. Për aplikimin dhe propozimin e kandidatëve për ndjekjen e kurseve institucionale të zbatohen kriteret e përcaktuara në lidhjet 4 dhe 5, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

V. Dispozita të përgjithshme

Me miratimin e kësaj rregulloreje, Procedurat Standarde të Veprimit për Arsimimin dhe Kualifikimin e Personelit të Forcave të Armatosura Brenda dhe Jashtë Vendit, miratuar me urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes nr. 329, datë 25/02/2015, shfuqizohet.